



Vlerësimi Institucional i Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri

**Raporti i Vlerësimit Institucional i
Universitetit "Fan.S. Noli Korçë
Prill 2017**

GRUPI I VLERËSIMIT:

Kevin Kendall Kryetar

Neil Casey Anëtar

Ana Kapaj Anëtare

Datë: Prill 2017

Përmbajtja

Rreth këtij vlerësimi.....	1
Konteksti i këtij vlerësimi	2
Raport i përmbledhur	3
Përmbledhje e gjetjeve.....	4
Gjykimi i përmbledhur	6
Raporti i detajuar.....	7
Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe menaxhimi i tij	7
Fusha e Vlerësimit 2: Burimet	11
Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula	15
Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi.....	19
Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre	23

Rreth këtij vlerësimi

Synimi i përgjithshëm i Vlerësimit Institucional është të vlerësojë se në çfarë shkalle i përmbush çdo IAL Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri, që kanë hyrë në fuqi në vitin 2011. Vlerësimi Institucional është procesi i vlerësimit nga grupi i ekspertëve të vlerësimit, që janë të specializuar në të njëjtën fushë, dhe çdo grup vlerësimi përbëhet nga një ndërthurje e ekspertëve nga Mbretëria e Bashkuar të caktuar nga QAA-ja dhe të ekspertëve shqiptarë të caktuar nga APAAL-i. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm drejtohet nga një ekspert i QAA-së.

Raportet përkatëse nuk shërbejnë vetëm për akreditimin institucional, që bazohet në shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të, por edhe për t'i ofruar IAL-ve, qeverisë shqiptare, publikut dhe studentëve informacion për mënyrën se si IAL-të përmbushin standardet. Ky raport, i ndihmon gjithashtu IAL-të të identifikojnë prioritetet për përmirësime (procesi që ofruesit e arsimit të lartë zbatojnë për përmirësimin sistematik të cilësisë së ofrimit dhe të mënyrave për mbështetjen e të nxënit të studentëve).

Standardet Shtetërore të Cilësisë në Shqipëri janë grupuar në pesë kapituj, Fusha Vlerësimi: Organizimi dhe Menaxhimi i tij; Burimet; Kurrikula; Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi; si dhe Studentët dhe Mbështetja e tyre. Ky raport identifikon karakteristikat e praktikave të mira, rekomandimet, pohimet e veprimeve të ndërmarra dhe dobësitë për çdo Fushë Vlerësimi, ndjekur nga një gjykim lidhur me shkallën e përmbushjes së standardeve nga IAL-të. Format e gjyimit që ekspertët mund të japin janë: standardet janë përmbushur plotësisht; standardet janë përmbushur kryesisht; standardet janë përmbushur pjesërisht; ose standardet nuk janë përmbushur.

Në fund, ekspertët do ta përmbyllin punën e tyre duke i rekomanduar Këshillit të Akreditimit të APAAL-it një gjykim të përmbledhur. Gjykimi i përmbledhur është një nga katër nivelet e mëposhtme:

- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur kryesisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur pjesërisht**
- **Standardet Shtetërore të Cilësisë nuk janë përmbushur.**

Në kuadrin e procesit të përgatitjes së raportit, QAA-ja ka siguruar ekspertë mbështetës për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm duke siguruar që grupi t'i mbështesë gjetjet në raport me fakte, si dhe për korrektimin dhe përmbledhjen e raportit të plotë për përmbledhjen që vijon.

Konteksti i këtij vlerësimi

Në vitin 1971, në Korçë, u themelua Instituti i Lartë i Bujqësisë, të cilin, në vitin 1992, Këshilli i Ministrave e emërtoi si Universiteti Politeknik i Korçës. Në vitin 1994, ai u bë Universiteti i Korçës, i njohur ndryshe edhe si Universiteti Fan S. Noli, sipas një personaliteti të shquar shqiptar. Universiteti është një institucion publik i arsimit të lartë në Shqipëri dhe ndodhet në pjesën verilindore të qytetit. Ai ka katër godina, tre prej të cilave ndodhen në kampus, si dhe Fakultetin e Burimeve Natyrore dhe Humane në pjesën tjetër të qytetit, ku ka zyra administrative, salla leksionesh dhe auditorë. Krahas këtyre, kompleksi i universitetit përfshin edhe dy konvikte dhe një fushë sportive.

Korça është një prej qyteteve kryesore të Shqipërisë Juglindore dhe rrethohet nga vargmalet e Moravës. Qyteti ndodhet afërsisht 869 m mbi nivelin e detit. Popullsia e rrethit të Korçës arrin në 194.000 persona, prej të cilëve 80,000 jetojnë në qytet.

Misioni i universitetit është të krijojë, përcjellë, zhvillojë dhe mbrojë njohuritë përmes mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve të tjera arsimore që ai ofron.

Vizioni strategjik i universitetit është integrimi i plotë në Zonën Evropiane të Kërkimit Shkencor duke ndërmarrë hapa reformues, që synojnë krijimin dhe mbrojtjen e standardeve të larta të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kërkimit, që përforcojnë arritjen e misionit të tij.

Universiteti përbëhet nga katër fakultete, përkatësisht: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane. Fakultetet ndahen në 14 departamente dhe tre nëngrupe arsimore. Universiteti ka dy Qendra Ekselence, Njësinë për të Nxënëit Gjatë Gjithë Jetës, Formim dhe Kërkim, si dhe Njësinë e Ekonomisë Eksperimentale Didaktike, që ofron kërkime dhe praktika profesionale në bujqësi.

Universiteti ofron 22 programe Bachelor, 13 programe Master Profesional, katër programe Master i Shkencave dhe një program doktorature. Numri aktual i studentëve arrin në 4.750, i stafit akademik me kohë të plotë në 156, ndërsa i personelit administrativ në 80.

Raport i përmbledhur

Raporti i Vetëvlerësimit u përgatit nga një grup i ngritur nga universiteti, që përbëhej nga anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë dhe të personelit administrativ të secilit fakultet, si dhe një përfaqësues i trupit studentor. Universiteti ka kritere specifike për përzgjedhjen e grupeve, të cilat, së bashku me Koordinatorin Institucional, hartuan një plan pune për përgatitjen e raportit në janar të vitit 2017. Universiteti bashkëpunoi plotësisht në procesin e vlerësimit, duke përgatitur një Raport Vetëvlerësimi dhe dokumente mbështetëse tejet të dobishme. Universiteti përgatiti edhe dokumente shtesë përpara dhe gjatë vizitës së vlerësimit, me kërkesë të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm.

Vizita u krye përgjatë dy ditëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm përbëhej nga dy ekspertë të arsimit të lartë me përvojë, nga Mbretëria e Bashkuar, dhe një anëtar me përvojë në arsimin e lartë nga personeli i institucionit shqiptar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm u mbështet nga Menaxheri i Vlerësimit dhe mbajtësi i shënimeve të siguruar nga APAAL, agjencia përgjegjëse për vlerësimet e arsimit të lartë në Shqipëri. Grupit të Vlerësimit të Jashtëm iu vu në dispozicion Raporti i Vetëvlerësimit dhe një dosje me dokumente mbështetëse, tetë javë përpara fillimit të vizitës së vlerësimit, të cilave iu shtuan më pas edhe dokumentet e kërkuara shtesë. U morën në konsideratë afërsisht 188 dokumente, të cilat i dhanë mundësinë grupit të njihes me strukturën, politikën, si dhe me procedurat e administrimit dhe natyrën e mësimdhënies dhe të veprimtarisë kërkimore të ndërmarrë nga universiteti. Dokumentet e shqyrtuara përfshinin: Statutin e Universitetit, rregulloret akademike, raportet vjetore, procedurat e pranimit dhe orientimit, gamën e marrëveshjeve të jashtme dhe shembujve të programeve të informimit, si dhe dokumentet nga mbledhjet vendimmarrëse.

Gjatë dy ditëve të vizitës së vlerësimit, u organizuan një sërë mbledhjesh, që i mundësuan Grupit të Vlerësimit të Jashtëm të kuptojë më mirë përgjegjësitë, procedurat dhe pikëpamjet e personelit dhe studentëve. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm takoi Rektorin, drejtuesit e nivelit të lartë, studentët, pedagogët, stafin akademik dhe personelin mbështetës, si dhe përfaqësuesit e palëve të interesit, institucioneve partnere dhe të alumni. Gjatë turit në kampus, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vizitoi bibliotekat, hapësirat e mësimdhënies, IT-së dhe të laboratorëve. Pasi shqyrtoi të gjitha dokumentet e disponueshme, grupi arriti në përfundimet e renditura si më poshtë.

Universiteti përmbush plotësisht standardet e Organizimit dhe Menaxhimit të tij. Ai ka një statut të shpallur, ku përcaktohen misioni, objektivat, statusi ligjor dhe drejtimi i organizatës, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë në Shqipëri. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm gjeti katër karakteristika të praktikës së mirë: së pari, Planin Strategjik të Zhvillimit; së dyti, personeli është tejet mbështetës dhe angazhohet në diskutime në shkallë universiteti; së treti, punën e Qendrës së Ekselencës për formimin e mësuesve në detyrë; dhe së fundi, suksesin e universitetit në ndjekjen e projekteve ndërkombëtare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim, si dhe nuk bëri asnjë pohim në lidhje me këtë fushë vlerësimi.

Universiteti i përmbush plotësisht standardet për Burimet. Përgjegjësia për buxhetimin dhe burimet përcaktohet në Statutin e Universitetit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron zhvillimin e kampusit dhe infrastrukturës së universitetit, të cilat kontribuojnë në një mjedis pozitiv të të nxënies për studentët, si një shembull të praktikës së mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, apo nuk dha asnjë rekomandim në lidhje me këtë fushë vlerësimi. Megjithatë, kjo fushë, kontribuon në ecurinë e digjitalizimit të universitetit dhe mbështet pohimin e bërë në Fushën e Vlerësimit 5, Studentët dhe Mbështetjen e Tyre.

Universiteti përmbush plotësisht standardet për Kurrikulën. Kërkohet që programet e universitetit të pasqyrojnë misionin, Planin Strategjik dhe strategjinë e tij të zhvillimit, dhe synohet kryesisht përmbushja e nevojave rajonale ekonomike dhe sociale. Grupi i Vlerësimit

të Jashtëm e konsideron qasjen ndaj hartimit të programit dhe kurrikulës, që mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së të diplomuarve në kontekstin e nevojave rajonale, si karakteristikë të praktikës së mirë. Krahas kësaj, edhe zhvillimi i ofertës kurrikulare dhe infrastrukturës mbështetëse të universitetit, që kanë rritur mundësitë e studentëve shqiptarë për të studiuar jashtë vendit, gjykohet si karakteristikë e praktikës së mirë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi, nuk dha asnjë rekomandim dhe nuk bëri asnjë pohim në këtë Fushë Vlerësimi.

Universiteti përmbush plotësisht standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin. Universiteti ka mekanizmat e duhura për të siguruar organizimin dhe dokumentimin efikas të programeve të studimit. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi tre karakteristika të praktikës së mirë në këtë Fushë Vlerësimi lidhur me mësimdhënien, mësimnxënien, kërkimin dhe mobilitetin. Shkëmbimi i përvojës midis anëtarëve me përvojë dhe pa përvojë të stafit akademik mundësohet përmes organizimit të seancave të hapura të mësimdhënies dhe formimit. Krahas kësaj, universiteti ka edhe njësinë e Ekonomisë Eksperimentale Didaktike, që mbështet kërkimin në Fakultetin e Bujqësisë. Universiteti është angazhuar në ndërkombëtarizim përmes mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, dhe në këtë kuadër, ka lidhur shumë marrëveshje me partnerët dhe është pjesë e shumë projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi një dobësi lidhur me priorizimin dhe koordinimin e fushave të kërkimit midis stafit akademik dhe studentëve, dhe rekomandoi se universiteti duhet të krijojë dhe zbatojë një strategji për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të fushave të kërkimit, të identifikuar si prioritet në Planin e tij Strategjik të Zhvillimit.

Universiteti përmbush plotësisht standardet për Studentët dhe Mbështetjen e Tyre. Organizimi, administrimi dhe mbështetja e studentëve bëhet në përputhje me Statutin e Universitetit dhe ligjin për arsimin e lartë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dy karakteristika të praktikës së mirë: së pari, punën aktuale për digjitalizimin e universitetit, që ka efekte pozitive në mbështetjen e studentëve; dhe së dyti mundësinë e mobilitetit të studentëve nëpërmjet projekteve ndërkombëtare si, Erasmus, siç përmenden në Fushën e Vlerësimit 4, së bashku me përgatitjen e listave të notave në gjuhën angleze për studentët që duan t'i transferojnë studimet e tyre jashtë vendit. Grupi nuk identifikoi asnjë dobësi apo nuk dha asnjë rekomandim lidhur me këtë Fushë Vlerësimi, por bëri dy pohime. Së pari, të vijohet me projektin tashmë në zbatim, që do të ndihmojë në digjitalizimin e bibliotekës dhe krijimin e bibliotekës online. Së dyti, universiteti ka prodhuar një kartë studenti, që do t'i ndihmojë studentëve të kenë akses falas, apo t'i ofrohen shërbime të ndryshme falas, ose me pagesë të reduktuar. Karta është prodhuar, por nuk është vënë ende plotësisht në funksion.

Përmbledhje e gjetjeve

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Qendra e Ekselencës për formimin e mësuesve në detyrë (pika 1.6, **Kapitulli III, Standardi III.1**)
- Personeli është tejet mbështetës dhe angazhohet në debate në shkallë universiteti (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi I.3**)
- Sukses në ndjekjen e projekteve ndërkombëtare (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- Plani Strategjik i Zhvillimit, duke përfshirë të gjithë personelin e departamenteve (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi I.5**)

- Qasja strategjike e universitetit kundrejt zhvillimit të kampusit dhe infrastrukturës së tij, që kontribuon në një mjedis pozitiv të të nxëniet për studentët (pika 2.8; **Kapitulli III Standardi V.1**)
- Qasja kundrejt hartimit të programit dhe kurrikulës, që mbështet zhvillimin e mundësive për punësimin e të diplomuarve në kontekstin e nevojave vendore (pika 3.3 dhe 3.11; **Kapitulli I Standardi I.3, Kapitulli I Standardi I.4**)
- Zhvillimi i ofertës kurrikulare dhe infrastrukturës mbështetëse të universitetit, që kanë rritur mundësitë e studentëve shqiptarë për të studiuar jashtë vendit (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.10**)
- Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, departamentet organizojnë seanca të hapura mësimdhënieje për shkëmbimin e përvojës së mësimdhënies midis anëtarëve të personelit, si dhe për vlerësimin e procesit të mësimdhënies së asistent pedagogëve (pika 4.4; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- Universiteti ka njësinë e Ekonomisë Eksperimentale Didaktike, që mbështet kërkimin në Fakultetin e Bujqësisë (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.6**)
- Universiteti është angazhuar në ndërkombëtarizim përmes mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, dhe ka lidhur shumë marrëveshje me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.3**)
- Programi i digjitalizimit të Universitetit, sistemi ESSE3 (pika 5.2; **Kapitulli I Standardi III.2**)
- Përgatitja e listës së notave në gjuhën angleze për studentët, nëse këta të fundit duan t'i transferojnë studimet e tyre jashtë vendit (pika 5.6; **Kapitulli I Standardi III.3**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Prioritizimi dhe koordinimi i fushave të kërkimit në shkallë departamenti midis stafit akademik dhe studentëve (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4, Kapitulli II Standardi I.6**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të jashtëm dha rekomandimin e mëposhtëm:

- Universiteti duhet të përgatisë dhe zbatojë një strategji për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të fushave të kërkimit, të identifikuar si prioritete në Planin e tij Strategjik të Zhvillimit (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4, Kapitulli II Standardi I.6**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Po zbatohet një projekt, që do të ndihmojë në digjitalizimin e bibliotekës dhe në krijimin e bibliotekës online (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**)
- Universiteti ka prodhuar një kartë studenti, që do t'i ndihmojë studentët të kenë akses falas, apo t'i ofrohen shërbime të ndryshme falas, ose me pagesë të reduktuar. Karta është prodhuar, por nuk është vënë ende plotësisht në funksion (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.5**).

Përmbledhje e gjykimeve për çdo Fushë Vlerësimi

- 1 Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur **plotësisht**.
- 2 Standardet për Burimet janë përmbushur **plotësisht**.
- 3 Standardet për Kurrikulën janë përmbushur **plotësisht**.
- 4 Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur **kryesisht**.
- 5 Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e Tyre janë përmbushur **plotësisht**.

Gjykimi i përmbledhur

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm i rekomandon Këshillit të Akreditimit se, në Universitetin e Korçës, Standardet Shtetërore të Cilësisë janë përmbushur plotësisht.

Raporti i detajuar

Fusha e Vlerësimit 1: Organizimi dhe Menaxhimi i tij

- 1.1 Statuti përcakton misionin, objektivat, statusin ligjor dhe drejtimin e organizatës të Universitetit [A21; B2; B3], si dhe procedurat e zgjedhjeve, organet vendimmarrëse, nivelet e autoritetit, sigurimin e cilësisë së programeve të studimit, regjistrimin dhe diplomimin e studentëve, të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit dhe studentëve, veprimtarinë kërkimore dhe çështjet financiare. Gjatë mbledhjeve me të gjithë personelin e universitetit, u evidentua se janë kuptuar pjesët përkatëse të Statutit [M1; M2; M3; M6; M7]. Statuti i ri është hartuar [A22] në pajtim me ndryshimet e ligjit për arsimin e lartë në Shqipëri, dhe është gati për t'u paraqitur për miratim. Rregullorja e veprimtarisë akademike dhe kërkimore e universitetit përshkruhet në Rregulloren e Studimeve [A23], e cila së bashku me Statutin, përbëjnë bazën për proceset e tjera operationale të universitetit, si për shembull Planin e Zhvillimit dhe Termat e Referencës së organeve [A24-A45].
- 1.2 Struktura organizative [A47; B2; B3] e universitetit është në përputhje me statutin, dhe kuptohet nga personeli [M1; M2; M3; M6; M7], që takoi Grupin e Vlerësimit të Jashtëm. Organet kryesore përbërëse të strukturës janë Bordi i Administrimit, Këshilli i Administrimit, Rektorati, Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Dekanati, Këshilli i Profesorëve, Këshilli Shkencor dhe Botues, si dhe Bordi Këshillimor. Autoriteti i tyre përcaktohet qartësisht në rregulloret përkatëse [A28-A36].
- 1.3 Rektorati e përgatit propozimin për buxhetin vjetor [A7], duke u mbështetur në feedback-un e departamenteve dhe fakulteteve [M6; M7]. Më pas, ai ia paraqitet Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit për miratim [A21; A48]. Që prej muajit dhjetor të vitit 2016, Bordi i Administrimit monitoron dhe kontrollon drejtimin administrativ, financiar, ekonomik dhe të veprimtarive të Universitetit sipas Statutit [A30].
- 1.4 Këshilli i Etikës ka rregullore të përcaktuara qartë [A36], dhe merr vendime [A59] në lidhje me çdo shkelje, duke i raportuar Rektorit.
- 1.5 Universiteti përbëhet nga katër fakultete, përkatësisht: Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, si dhe Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane [A7]. Këto fakultete janë të ndara në 14 departamente [A7]. Këshillat e Fakultetit janë zëvendësuar tashmë nga Dekanatet, të drejtuara nga Dekani, funksioni kryesor i të cilit është të kontribuojë në Planin Strategjik të universitetit dhe të koordinojë funksionet akademike dhe kërkimore të departamenteve [A7; M3; M6; M7].
- 1.6 Universiteti ka dy Qendra Ekselence [A7; M5; M6; M7], si dhe Njësinë e Ekonomisë Eksperimentale Didaktike, që është pjesë e Fakultetit të Bujqësisë dhe pjesë përbërëse e njësisë së mësimdhënies dhe kërkimit [<http://www.unkorce.edu.al/en/didactic-experimental-economy>]. Qendra e Ekselencës në Fakultetin e Edukimit dhe Filologjisë ofron programe për formimin e mësuesve në detyrë si për stafin akademik të universitetit, ashtu edhe për ata jashtë tij. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron këtë Qendër Ekselence për formimin e mësuesve në detyrë si një karakteristikë të praktikës së mirë, që përmirëson përvojën e mësimnxënies së studentëve në të gjithë rajonin.
- 1.7 Këshilli i Profesorëve u ngrit në vitin 2010, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë, dhe organizon dhe administron studimet e doktoraturës dhe kualifikimet pas doktorature të stafit akademik [A7; A13; A14; A31]. Këshilli, gjatë periudhës së

ushtrimit të veprimtarisë së tij, ka vlerësuar dhe nxitur kualifikimet e 28 profesorëve të asociuar, tetë mësuesve dhe një doktoranti [A7].

- 1.8 Përgjegjësit e departamenteve administrojnë programet e studimit dhe koordinojnë mësimdhënien, mësimnxënien dhe veprimtarinë kërkimore në shkallë departamenti, duke raportuar tek Dekani i Fakultetit, i cili koordinon veprimtaritë e departamenteve [A7; M3; M6]. Anëtarët e Senatit akademik, anëtarët e Bordit të Administrimit, Rektori, dekanët e fakulteteve, dhe përgjegjësit e departamenteve zgjidhen me votim të fshehtë nga stafi akademik [A46].
- 1.9 Organet e universitetit mblidhen rregullisht sipas termave të referencës [A24-A45] dhe çështjet për diskutim bëhen të ditura paraprakisht. Gjatë mbledhjeve me personelin [M3; M6; M7] dhe analizimit të procesverbaleve të mbledhjeve [B4-B8], Grupi i Vlerësimit të Jashtëm evidentoi se ata përfshihen rregullisht në vendimet e universitetit dhe se iu dëgjohet fjala jo vetën në lidhje me çështje që janë të rëndësishme për ta, por edhe për universitetin. Personeli është tejet mbështetës dhe i angazhuar në debate në shkallë universiteti, gjë që Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron si **praktikë të mirë**. Vendimet e Senatit Akademik dhe të Bordit të Administrimit kthehen në dekrete, që ruhen në bazën e të dhënave të Rektoratit [A7].
- 1.10 Paragrafët e mësipërm vërtetojnë se universiteti funksionon brenda kufijve të autonomisë, të caktuara nga statuti dhe ligji për arsimin e lartë në Shqipëri. Siç përshkruhet edhe më sipër, ai ka struktura për mbikëqyrjen dhe vetëvlerësimin e proceseve të tij. Krahas kësaj, universiteti ka edhe Njësinë e Sigurimit të Cilësisë [A20; A39] për monitorimin e proceseve të brendshme, që përmbillet me përgatitjen e Raportit të Vetëvlerësimit [A93] dhe Planit të Veprimit [A94]. Krahas kësaj, universiteti kryen vlerësimin e jashtëm, i cili përmbillet me hartimin e Planit të Veprimit [C1].
- 1.11 Universiteti ka marrë pjesë në 26 projektet ndërkombëtare lidhur me të nxënësit gjatë gjithë jetës, të nxënësit në distancë, mobilitetin e personelit dhe studentëve, si dhe sigurimin e cilësisë. Pavarësisht shkallës së ulët aktuale të pjesëmarrjes si të personelit, ashtu edhe studentëve, gjatë pesë viteve të fundit, 91,95 për qind e mësuesve nuk kanë punuar jashtë vendit, ndërsa 97,33 për qind e studentëve nuk kanë studiuar jashtë vendit [Anketimi i Mësuesve dhe Studentëve]. Personeli dhe studentët që takuan Grupin e Vlerësimit të Jashtëm ishin tejet mbështetës kundrejt këtyre nismave. Universiteti ka qenë i suksesshëm në ndjekjen e projekteve ndërkombëtare, gjë që duhet përkthyer në rritjen e mobilitetit të personelit dhe studentëve, dhe konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si **praktikë e mirë**.
- 1.12 Programi i Zhvillimit Afatmesëm (2008-2013), [A24] që është përditësuar së fundmi me Planin Strategjik të Zhvillimit, përshkruan planet për zhvillimin e universitetit në kontekstin e rajonit të Korçës, të cilat janë ndjekur me sukses nga universiteti përgjatë disa viteve. Për përmbajtjen e tij, i cili gëzon edhe mbështetjen e punëdhënësve kyç të rajonit [M5], janë organizuar konsultime gjithëpërfshirëse në shkallë universiteti [M3; M6; M7]. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron përfshirjen e të gjithë personelit të universitetit në përgatitjen e Planit Strategjik të Zhvillimit si karakteristikë të **praktikës së mirë**. Planet përkojnë me Misionin dhe Vizionin Strategjik të Universitetit [A7] dhe me nevojat rajonale të punësimit [M5].
- 1.13 Çdo departament i universitetit përgatit raportin vjetor për veprimtarinë e tij [A51; A52-A53], që përfshihet në Raportin e Fakultetit dhe së fundi në Raportin e Universitetit [A50]. Pas miratimit nga Senati dhe Bordi i Administrimit, ai i paraqitet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përgatit

Planin e Veprimit të Përmirësimit **[A94]** në mbështetje të gjetjeve të tij.

- 1.14 Strukturat e universitetit, të përmendura më sipër, janë të përshtatshme për përmbushjen e misionit dhe qëllimit të tij. Universiteti ofron 22 programe Bachelor, 17 programe Masteri dhe 1 doktorature, të cilat jepen nga 156 anëtarë të stafit akademik me kohë të plotë **[A7]**. Faqja e internetit e universitetit [\[www.unkorce.edu.al\]](http://www.unkorce.edu.al) përditësohet vazhdimisht me informacion rreth universitetit dhe programeve të tij të studimit, si në gjuhën shqipe, ashtu edhe në gjuhën angleze **[M7]**.
- 1.15 Propozimet për programet e reja vijnë si rezultat i kërkimit të tregut, si për shembull në rastin e Masterit Profesional në Administrim Publik **[A61]** dhe programit dyvjeçar profesional për Mësuesit e Fëmijërisë së Hershme **[A62]**. Për Grupin e Vlerësimit të Jashtëm ishte më se e qartë se ishin konsultuar si punëdhënësit e sektorit publik të rajonit të Korçës, ashtu edhe ato të sektorit privat, të cilët kishin mbështetur zhvillimet e reja të programit nga ana e universitetit **[M5]**. Universiteti ka një Qendër Karriere aktive, që komunikon me Zyrën Rajonale të Punësimit për t'iu ofruar studentëve informacion rreth mundësive për punësim **[A124]**. Qendra kryen edhe kërkime për punësimin në rajonin e Korçës **[A27]**.
- 1.16 Universiteti ndjek një strategji bashkëpunimi dhe partneriteti të hapur në shkallë rajonale, kombëtare dhe ndërkombëtare, siç vërtetohet nga dokumentacioni **[A96-A106; C3; C4]** dhe diskutimet me personelin **[M2; M3; M6; M7]**. Diapazoni i bashkëpunimeve përfshin ato për kërkim, mobilitet dhe praktikë profesionale **[M3; M4; M6]**. Gjithashtu, universiteti nxit regjistrimin e studentëve të huaj në programet e tij dhe stafin e huaj akademik në mësimdhënie, në përputhje me Statutin e tij **[A21]**, megjithëse ende nuk praktikohet gjerësisht. Për ta lehtësuar këtë objektiv, universiteti ka në plan të rrisë numrin e programeve të ofruara në gjuhën angleze, **[A7]**. Kjo gjë mbështet praktikën e mirë të përshkruar në seksionin 1.11.

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Qendra e Ekselencës për formimin e mësuesve në detyrë (pika 1.6, **Kapitulli III, Standardi III.1**)
- Personeli është tejet mbështetës dhe angazhohet nëpër debate në shkallë universiteti (pika 1.9; **Kapitulli III Standardi I.3**)
- Sukses në ndjekjen e projekteve ndërkombëtare (pika 1.11; **Kapitulli III Standardi III.4**)
- Plani Strategjik i Zhvillimit, duke përfshirë të gjithë personelin e departamenteve (pika 1.12; **Kapitulli III Standardi I.5**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Organizimin dhe Menaxhimin e tij janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 2: Burimet

- 2.1 Struktura organizative e universitetit miratohet nga Senati Akademik dhe më pas publikohet në faqen e internetit të institucionit [<http://www.unkorce.edu.al/en/organizimi>; **A47; A122**]. Rekrutimi i personelit bëhet në përputhje me kërkesat ligjore përmes parimeve të Statutit dhe procedurave në Rregulloren e Studimeve. Të sapoemëruarve iu ofrohet orientim rreth universitetit dhe departamentit [**A21-23**; <http://www.unkorce.edu.al/sq/node/561>; **M6**]. Personeli me kohë të pjesshme emërohet në fillim të çdo viti akademik. Universitetit i është kërkuar të rrisë numrin e anëtarëve të stafit me kohë të pjesshme për disa programe profesionale, për shkak të pamjaftueshmërisë së specialistëve në rajon [**M3; SER fq.20**].
- 2.2 Për të nxitur integrimin e personelit [**B3; B4; M6**] organizohen mbledhje të rregullta në shkallë departamenti, fakulteti dhe rektorati. Kjo gjë pasqyrohet edhe në qasjen e universitetit kundrejt përgatitjes së Planit Strategjik, ku çdo fakultet kreu analizën SWOT për veprimtaritë arsimore dhe kërkimore, përfundimet e të cilave u përfshinë edhe në objektiva, që u pranuan nga Rektorati dhe u miratuan nga Senati Akademik [**A26; M2; A93; A94; M6**]. Grupi që përgatiti Raportin e Vetëvlerësimit të universitetit, përbëhej nga një student dhe përfaqësues nga çdo fakultet [**A7; M1**]. Departamentet administrative të Rektoratit janë përgjegjëse për ofrimin e informacionit për personelin. Nëpër fakultete, zhvillohet edhe një program Leksionesh të Hapura, ku pjesëmarrja nuk është e detyrueshme, por ata anëtarë personeli që kanë marrë pjesë, e përshkruan si një mënyrë mjaft të dobishme për zhvillimin e marrëdhënieve brenda universitetit [**A89; M6; M7**]. Gjithashtu, universiteti promovon një sërë veprimtarish për integrimin social, gjë që vlerësohet nga personeli [<http://www.unkorce.edu.al/sq/node/743>; **M6**].
- 2.3 Vlerësimi i stafit akademik kryhet gjatë vlerësimeve në fund të semestrit, të cilat administrohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) dhe mbikëqyret nga përgjegjësit e departamenteve. Vlerësimet përmbillen me raporte vjetore në shkallë departamenti, që përfshihen në raportet e fakultetit dhe planet e veprimit. Ngritja në detyrë e personelit duhet bërë duke marrë parasysh përfundimet e vlerësimit [**A63; B12; M3; A92; A93; A94; B31; M6; B9; B18; B19**]. Performanca e stafit akademik kundrejt përshkrimit të pozicionit të punës vlerësohet rregullisht gjatë mbledhjeve të ndryshme në Rektorat, dhe përmbillet me Raportin e Vlerësimit të Performancës. Dega e Kurrikulave dhe Vlerësimit Institucional po kërkon të marrë feedback më të plotë rreth përvojës akademike nga alumni [**A62; B11; M3; M4**]. Përgjegjësit e departamenteve dhe dekanët e fakulteteve vlerësohen kundrejt objektivave të departamentit dhe fakultetit, dhe Marrëveshjes së Ngarkesës Vjetore. Përfundimet shqyrtohen nga Rektorati, që përgatit Raportin e përgjithshëm Vjetor për Veprimtarinë Shkencore dhe Financiare, në përputhje me kërkesat e Ministrisë [**A50; A63; M3; M6; B9**].
- 2.4 Sektori Juridik i Degës së Burimeve Njerëzore mirëmban bazën e të dhënave të kontratave dhe dosjeve të personelit. Përshkrimet e pozicioneve të punës janë në përputhje me funksionet e përcaktuara në Statut dhe Rregulloren e Studimeve [**A21; A22; A23; A70**]. Marrëveshja e Ngarkesës Vjetore, lidhet në fillim të vitit [**A69**], në përputhje me kërkesat statutoare. Raporti Vjetor që i dërgohet Ministrisë, përfshin një seksion për Stafin Akademik dhe Ngarkesën, që pasqyron efektshmërinë e universitetit në koordinimin e veprimtarive të ndryshme, duke përfshirë mësimdhënien, kërkimin, punën administrative dhe përhapjen e njohurive [**50**]. Universiteti ndjek një politikë zhvillimi sociale, që përfshin si zhvillimin e universitetit si një rrjet social për punonjësit, ashtu edhe nxitjen e zhvillimit rajonal dhe ndërkuftar [**SER fq. 23; M4; M5; M6; http://www.unkorce.edu.al/sq/node/743**].

- 2.5 Universiteti e harton buxhetin në përputhje me udhëzimet statutorë. Hartimi i tij mbikëqyret nga Rektorati, ndërsa Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit e miraton **[A7 fq. 24; A21; A23; A38; A48]**. Politika financiare, duke përfshirë monitorimin e rregullt të performancës, mbikëqyret nga Kancelari i Universitetit, në përputhje me politikën e universitetit **[A38]**. Rektorati, Senati Akademik dhe Këshilli i Administrimit organizojnë mbledhje mujore për të monitoruar performancën kundrejt buxhetit **[A7 fq.25; A48; B10;A21; A28; A29]**. Buxheti i nënshtrohet auditit të brendshëm dhe auditit të jashtëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit çdo dy vjet dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit çdo katër vjet **[B13; A7 fq.26; M3]**. Gjatë mbledhjes së stafit akademik dhe personelit administrativ me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, doli që, procedurat financiare dhe buxhetore ishin kuptuar mirë **[M6; M7]**.
- 2.6 Sistemi i informacionit institucional menaxhohet përmes Rrjetit Akademik Shqiptar, që i ofron universitetit hapësirën e bazës së të dhënave për qëllimet e mësimnxënies, mësimdhënies, kërkimit, administrimit të burimeve njerëzore, financiar dhe administrativ. Politikat, përgjegjësitë dhe praktikat operacionale **[A7 fq.26; A43]** përcaktohen në rregulloren e universitetit. Rrjeti i universitetit koordinohet në shkallë qendrore nga Dega e Informacionit dhe Transferimit të Njohurive, dhe përdoret për të koordinuar informacionin midis universitetit dhe organeve kombëtare, duke përfshirë Ministrinë e Arsimit dhe Sportit **[A43]**. Të gjitha fakultetet, duke përfshirë edhe bibliotekën e fakultetit, janë të pajisura me kompjuterë dhe kanë akses në internet, në mënyrë që të mbështeten shprehitë e teknologjisë së informacionit për programet e studimit **[Turi i Kampusit; A79; M7]**. Studentët u shprehën pozitivisht për cilësinë e teknologjisë së informacionit të universitetit **[M4; Anketimi i Studentëve]**.
- 2.7 Faqja zyrtare e internetit të universitetit, që është në gjuhën shqipe dhe angleze, ofron informacion të saktë rreth pranimeve, veprimtarive akademike, programeve të studimit dhe njësive të tyre, sigurimit të cilësisë dhe dokumenteve mbështetëse të studentëve **[<http://www.unkorce.edu.al/>]**. Universiteti përgatit një gamë standarde botimesh promovuese, duke përfshirë udhëzuesin e universitetit dhe broshurat për programet individuale të studimit **[A127; <http://www.unkorce.edu.al/>]**. Studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm e vlerësuan pozitivisht informacionin që merrnin, gjë që përkonte me rezultatet e Anketimit të Studentëve **[M4; Anketimi i Studentëve ; A79]**.
- 2.8 Godinat e universitetit, që ndodhet në afërsi të qendrës së qytetit, janë të mirëmbajtura. Auditorët kanë kushte të mira, janë të pajisur me mjete audio-vizuale, duke përfshirë kompjuterë personalë dhe projektorë **[Turi i Kampusit]**. Përgjegjës për mbikëqyrjen e pronave dhe administrimin e ambienteve është Bordi i Administrimit **[B1; B2; A21]**. Qasja e universitetit kundrejt zhvillimit të ambienteve të tij të mësimdhënies është sistematike, me objektiva të qarta, të përcaktuara në Planin strategjik **[A7, M3]**. Universiteti po punon ngushtësisht me Bashkinë e Korçës dhe ka blerë ish-godinën e Bashkisë së Korçës, që ndodhet pranë kampusit, e cila aktualisht po rikonstruhohet për të ofruar ambiente të reja mësimdhënieje dhe zyra administrative, që do të përmirësojnë mësimdhënien dhe mësimnxënien **[Turi i Kampusit ; M2; M5; M7; A24; A26]**. Universiteti ka arkivën dhe këndin muzeor, që mbledh të gjitha dëshmitë e trashëgimisë akademike të universitetit **[<http://www.unkorce.edu.al/en/article/historiku-i-universitetit-0>; Turi i Kampusit]**. Studentët dhe stafi akademik që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm i vlerësuan ambientet dhe pronat e universitetit, duke u shprehur se ofronin një mjedis produktiv mësimnxënieje **[M4, M6]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se qasja sistematike e universitetit kundrejt zhvillimit të kampusit dhe infrastrukturës, që kontribuon në një mjedis pozitiv mësimnxënieje për studentët, përbën një karakteristikë të **praktikës së mirë**.

- 2.9 Raporti i Vetëvlerësimit përshkruan rrugën që ndjek universiteti për të përmbushur kërkesat për hapësirat akademike dhe veprimtari të tjera. Shkalla e përputhshmërisë është përmirësuar që pas blerjes së godinës së re nga bashkia **[A17]**. Auditorët, laboratorët dhe sallat e leksioneve janë të pajisur me video projektorë, si dhe çdo fakultet ka sallën e video konferencave, departamentet, bibliotekën dhe mbi 300 kompjuterë të lidhur me internetin. Për më tepër, siç vihet në dukje edhe në pikën 2.8, godinat ndodhen në një kampus që ofron hapësira të gjelbra **[A50; Turi i Kampusit; A7, fq. 30-31]**. E gjithë infrastruktura e kampusit monitorohet, duke përfshirë edhe Këshillin Studentor, që në vitin 2015 bashkëpunoi me Qendrën e Karrierës së Universitetit për të organizuar një anketim për studentët në ambientet e mësimdhënies dhe mësimnxënies. **[A91]**. Bibliotekat e universitetit funksionojnë mbi bazën e një sistemi kryesisht manual të huadhënies së librave. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm raportoi se ekziston një projekt për vënien në punë të një sistemi digjital, për të cilin nevojiten më shumë fonde, dhe pikërisht për këtë arsye, nuk është caktuar asnjë datë për përfundimin e projektit **[M7; Turi i Kampusit]**. Grupi arriti në përfundimin se kjo gjë kontribuon në pohimin e bërë në Fushën e Vlerësimit 5.
- 2.10 Strukturat administrative të universitetit dhe fakultetit publikohen në dokumentet kyçe dhe në faqen e internetit të universitetit **[B2; B3; <http://www.unkorce.edu.al/en/organizimi>]**. Sektori i Protokollit dhe Arkivës është përgjegjës për ruajtjen e të gjitha dokumenteve të nevojshme për universitetin, mbikëqyrjen e dokumenteve në format të shtypur dhe bazës elektronike të të dhënave të personelit, si dhe dosjeve të studentëve dhe të kërkimit, në përputhje me rregulloren përkatëse të Rektoratit. Këtu përfshihen edhe dosjet e plota të studentëve duke filluar me regjistrimin, duke vazhduar me provimet, e duke përfunduar me diplomimin **[A35; A36; M7]**. Universiteti është i ndërgjegjshëm se nëse rritet numri i studentëve, do të lindë nevoja e krijimit të bazës elektronike të të dhënave për ruajtjen e informacionit **[A7 fq. 32; M7]**.

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi karakteristikën e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Qasja sistematike e universitetit për zhvillimin e mëtejshëm të kampusit dhe infrastrukturës, gjë që kontribuon në një mjedis pozitiv të të nxëniet për studentët (pika 9.8; **Kapitulli III Standardi V.1**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Burimet janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 3: Kurrikula

- 3.1 Kërkohej që programet e universitetit të pasqyrojnë Misionin, Planin Strategjik dhe Strategjinë e Zhvillimit të Universitetit. Ai synon kryesisht përmbushjen e nevojave rajonale ekonomike dhe sociale. Për të siguruar përputhshmërinë me nevojat rajonale, në fund të vitit, universiteti rishikon të gjitha objektivat strategjike lidhur me mësimdhënien dhe kërkimin [A23; A24; A25; A26; M2], duke e vënë theksin gjatë këtyre viteve të fundit kryesisht te bujqësia dhe profesionalizimi i mësimdhënies. Universiteti kontakton vazhdimisht me Drejtorinë Arsimore Rajonale dhe punëdhënësit e tjerë [A99; A129; M2; M6; M7]. Objektivat strategjike kanë nxitur edhe rritjen e angazhimit të mëtejshëm me punëdhënësit, si dhe zhvillimin e programeve profesionale dyvjeçare [A99; A129; M2].
- 3.2 Universiteti ofron kualifikime përgjatë të tre cikleve me 22 programe Bachelor, 13 Master Profesional, katër Master i Shkencave dhe një program Doktorature. Universiteti po planifikon të ofrojë edhe certifikata dyvjeçare profesionale dhe profesioni [A3; M2]. Në faqen e internetit të institucionit, publikohen informacione rreth programeve të studimit, duke përfshirë informacione për strukturën e kursit, për mësimdhënien dhe mësimnxënien, si dhe për kreditet ECTS [<http://www.unkorce.edu.al/sq/studime-bachelor-koh%C3%AB-e-plot%C3%AB>]. Në Manualin e Universitetit dhe në fletëpalosjet e programeve përkatëse të studimit botohen informacione më të hollësishme, duke përfshirë edhe mundësitë për pranimit dhe punësim. [A123; A23; A158]. Në rregulloret e secilit program studimi ofrohet informacioni përfundimtar rreth rezultateve të mësimdhënies, programeve mësimore, vlerësimit dhe aspekteve të tjera të kursit [A107-117; A23, Neni, 40-42, 44-47, 56].
- 3.3 Programi i Zhvillimit Afatmesëm i universitetit (2008-2013) trajtonte prioritetet e ministrisë, duke u përqendruar te faktorët kombëtarë dhe rajonalë. Programi merrte parasysh edhe prioritetet sociale dhe ekonomike të rajonit të Shqipërisë Juglindore, ku përfshihet edhe Korça, si dhe nxiste zhvillimet në matematikë, në shkencë, si dhe në fushat e zbatuara, duke përfshirë bujqësinë, administrim biznesin dhe arsimin. Planin Strategjik i Zhvillimit (2016-2020) plotëson planin e mëparshëm, duke e shtrirë theksin e planit strategjik edhe te politikat e ndërkombëtarizimit [A24; A26; M2; M3; A61; A123]. Universiteti arriti të lidhte një sërë marrëveshjesh të reja me Projektin Tempus, duke synuar nxitjen e mobilitetit të studentëve dhe personelit, si dhe përgatitjen e kurrikulës së re. Si shembull mund të merret masteri i përbashkët me universitetet e Greqisë dhe Azerbajxhanit, që është një bashkëpunim ndërkufitar i financuar nga Bashkimi Evropian, i cili ka sjellë futjen e programit të Masterit në Menaxhimin dhe Transportimin e Naftës dhe Gazit [C4.1; C4.2; C4.3; C4.4; C4.5; C4.6; M2; M3; M4]. Punëdhënësit që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm kishin dijeni për strategjinë e universitetit dhe përmendën disa prej bashkëpunimeve me përfitime të ndërsjella, duke përfshirë edhe krijimin e një godine të re universitare (shihni FV 2) dhe përfshirjen e punëdhënësve në Këshillin Këshillimor të universitetit [M5; A15]. Kjo qasje strategjike kontribuon edhe në karakteristikën e praktikës së mirë të identifikuar në pikën 3.11 [A24; A26].
- 3.4 Ngarkesa e stafit akademik me kohë të plotë shpërndahet ndërmjet veprimtarive të mësimdhënies, kërkimore dhe të transferimit të njohurive, si dhe veprimtarive që mbështesin misionin e institucionit në përputhje me kërkesat statutore [A7, fq.36; A69]. Për të ulur kërkesat për personel me kohë të pjesshme, personeli me kohë të plotë mund ta tejkalojë normën e caktuar [A69; M7]. Orët e realizuara të punës regjistrohen nga përgjegjësit e departamenteve përgjatë vitit, dhe monitorohen nga Dega e Financës në fund të vitit [A71; M6; M7].

- 3.5 Siç vihet re, rregulloret përkufizuese të secilit program studimi përfshijnë informacion të përgjithshëm rreth kurrikulës, mësimdhënies dhe mësimnxënies, vlerësimit, pranimeve, infrastrukturës dhe mbështetjes, si dhe mundësive për punësim. Rregulloret dhe informacioni për çdo njësi hidhen në faqen e internetit dhe janë të disponueshme në sistemin digjital ESSE3 të universitetit [A107-117; <http://www.unkorce.edu.al/en/node/751>; www.unkorce.esse3]. Ky informacion ofrohet më i zgjeruar nga stafi akademik gjatë leksioneve të para [A23, Neni 85-86; M4]. Kriteret e pranimit hartohen nga departamentet përkatëse, miratohen nga Senati Akademik dhe më pas i dërgohen ministrisë [A23, Neni 20; A128; A54; <http://www.unkorce.edu.al/sq/node/763>]. Studentët janë të kënaqur me informacionin që iu ofrohet rreth programeve. [Anketimi i Studentëve; M4].
- 3.6 Në hartimin e programeve të ciklit të parë janë përfshirë njohuritë bazë për parimet dhe metodat kryesore shkencore, si dhe shprehjet specifike të lëndës. Objektivat e mësimnxënies ndahen në kompetenca të përgjithshme dhe specifike të lëndës, në lidhje me, përkatësisht, kërkesat e kualifikimit të përgjithshëm dhe programit aktual të studimit [A21, Neni 33; A107-117; <http://www.unkorce.edu.al/en/node/751>; www.unkorce.esse3]. Shumë programe të ciklit të parë synojnë të përfshijnë në vetvete punësueshmërinë. Ka përjashtime vetëm për programet e arsimit profesional, ku studentëve iu duhet të ndjekin një program të ciklit të dytë për t'u praktikuar [A107-117]. Në Rregulloren e Studimeve dhe në rregulloret përkatëse të programeve të studimeve përcaktohen procedurat e transferimit të krediteve dhe të njehsimit, në përputhje me Kartën e Bolonjës (shihni 3.9) [A23; A107-11].
- 3.7 Nën kujdesin e qendrës së Karrierës, studentëve iu ofrohet orientim, i cili përfshin informacione për universitetin dhe programet e studimit. Studentëve të ciklit të tretë iu ofrohet një version i posaçëm, ku përcaktohet vendndodhja specifike e departamentit të tyre [M4; A21, Neni 8; A124]. Në anketime, që kryhen rregullisht, përfshihet edhe orientimi dhe aspekte të tjera të ecursisë së studentëve. Rezultatet diskutohen në mbledhjet në shkallë fakulteti dhe dekanati [A49; A51-53; A92; A23; Anketimi i Studentëve]. Studentët që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm vlerësuan orientimin e ofruar, si në lidhje me dokumentacionin, ashtu edhe me vëmendjen e treguar nga personeli [M4; Anketimi i Studentëve].
- 3.8 Në rregulloret e ciklit të dytë kërkohet që, programet e studimit të formojnë mendimtarë kritikë, duke i pajisur me njohuri të specializuara dhe shprehje kërkimore, të cilat parashikohet të ofrohen nga anëtarët e stafit me kohë të plotë me formim kërkimor. Të gjitha programet e masterit përfshijnë një element të praktikës profesionale, të realizuar në bashkëpunim me organizatat publike dhe private të rajonit [A111-116; M4; M6; A27]. Studentët që ndjekin programin e masterit dhe alumni, e vlerësuan pozitivisht praktikën profesionale, duke vënë në dukje si mbështetjen e personelit të universitetit në përcaktimin e vendit ku të praktikës, ashtu edhe vlerën e saj në zhvillimin e punësueshmërisë (shihni seksionin 3.11) [M4; M7].
- 3.9 Universiteti ka kërkuar të hartojë një platformë për programet e tij të studimit për të nxitur mobilitetin e studentëve shqiptarë në Evropë e më gjerë. Programet janë hartuar në mënyrë të tillë që të përmbushin kërkesat e Procesit të Bolonjës, si dhe përfshijnë rregulloret për transferimin e studentëve për kandidatët që vijnë nga jashtë [A23, Pika 62; A56; A4.1-4.11]. Përshkrimet e programeve janë publikuar në faqen e internetit në gjuhën angleze [p.sh, <http://www.unkorce.edu.al/en/bachelor-study-full-time>]. Studentët e ciklit të dytë dhe të tretë duhet të japin provimin e gjuhës angleze përpara se të diplomohen [A21, Pika 33]. Studentëve iu jepet suplementi i diplomës së bashku me certifikatën e diplomimit [A23, Neni 63; B18.1; B18.2; B18.3]. Përgjegjëse për të nxitur dhe

ndihmuar në organizimin e mobilitetit të studentëve është Qendra e Karrierës. Ajo shpall mundësitë dhe i ndihmon studentët me aplikimet [M3; M4; A74; M6]. Grupi u takua me studentët që kishin përfituar nga shkëmbimi në disa vende evropiane përmes projekteve Tempus dhe Erasmus +, ndërsa studentët e tjerë u shprehën se ajo çka i frenonte për të studiuar jashtë ishin shpenzimet [M4; M3; M2; C3; M6; M7]. Drejtuesit e universitetit pohuan se do të donin që nga përvoja e të studiuarit jashtë vendit të përfitonin më shumë studentë. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e konsideron zhvillimin e ofertës kurrikulare dhe infrastrukturës mbështetëse, që i kanë ofruar studentëve shqiptarë më shumë mundësi për të studiuar jashtë, si një karakteristikë të **praktikës së mirë**.

3.10 Qasja strategjike e universitetit kundrejt kurrikulës së tij ka mundësuar integrimin e efektshëm të elementeve praktike dhe teorike në programin e studimit [A99; A129; M2; M7]. Të gjitha programet e cikleve të dyta dhe disa programe të përzgjedhura të ciklit të parë përmbajnë njëfarë praktike profesionale. Krahas kësaj, një sërë programesh studimi nga të gjitha fakultetet po i nënshtrohen Vlerësimit të Kurrikulës së Universitetit të Mbështetur në Kompetenca, si rezultat i të cilit do të krijohet kuadri institucional i kompetencave dhe do të hartohen kompetencat për çdo program studimi [A107-117; A64; M3; M7].

3.11 Kërkohej që programet e studimit të tregojnë se si do të ofrohen mundësitë për punësimin e studentëve [A23; A107-117]. Për më tepër, siç theksohet edhe në pikën 3.1, planifikimi strategjik i universitetit ka kërkuar përfshirjen e punësueshmërisë në kurrikul përmes nismave të ndryshme, duke përfshirë edhe angazhimin e punëdhënësve rajonalë dhe hartimin e programeve dyvjeçare profesionale dhe profesioni, duke përfshirë edhe Infermierinë dhe Mjekësinë Veterinare (shihni edhe 3.11) [M2; A25; A26; A99; A129; M7]. Studentët u shprehën pozitivisht për praktikën profesionale, duke vlerësuar rolin e saj në zhvillimin e punësueshmërisë [M4, Anketimi i Studentëve]. Gjithashtu, universiteti bashkëpunon me Bashkinë e Korçës për organizimin e panairëve të karrierës [M4; Anketimi i Studentëve; M7]. Disa studentë dhe punëdhënës që u takuan me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm ishin të mendimit se do të ishte i dobishëm shtimi i mundësive më të qëndrueshme për të vënë në zbatim njohuritë dhe kryer praktikën profesionale. Megjithatë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm shqyrtoi edhe shkallën e zhvillimit të kurrikulës nga strategjia e universitetit, si dhe shkallën e integritetit të elementeve teorike dhe praktike të programeve për t'i ndihmuar studentët në punësueshmëri. Për më tepër, këto mundësi përafrohen me nevojat rajonale të zhvillimit social dhe ekonomik. Si rrjedhojë, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm arriti në përfundimin se qasja kundrejt hartimit të programit dhe kurrikulës, që mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së të diplomuarve në kontekstin e nevojave rajonale, përbën një karakteristikë të **praktikës së mirë** [A23; A24; A26; M4; M5; M6].

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- zhvillimin e ofertës kurrikulare dhe infrastrukturës mbështetëse, që i kanë ofruar studentëve shqiptarë më shumë mundësi për të studiuar jashtë vendit (pika 3.9; **Kapitulli I Standardi I.10**)
- qasja kundrejt hartimit të programit dhe kurrikulës, që mbështet zhvillimin e punësueshmërisë së të diplomuarve në kontekstin e nevojave rajonale (pikat 3.3 dhe 3.11; **Kapitulli I Standardi I.3, Kapitulli I Standardi I.4**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk pohoi asnjë veprim.

Gjykimi

Standardet për Kurrikulën janë përmbushur plotësisht.

Fusha e Vlerësimit 4: Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kërkimi

- 4.1 Universiteti zotëron mekanizmat e duhura për sigurimin e organizimit dhe dokumentimit efikas të programeve të studimit [A21, A7 fq.44]. Struktura e programit dhe përmbajtja e kurrikulës diskutohen dhe miratohen në shkallë departamenti [B5, M6]. Versioni i miratuar nënshkruhet nga Rektori, dekani i fakultetit dhe Përgjegjësi i Departamentit [A21]. Syllabusi dhe kurrikula e programeve të studimeve hartohen në mënyrë të tillë që të përmbushen objektivat e përgjithshme të programit të studimit, që përcaktohen qartësisht në Statutin e Universitetit dhe Planin Strategjik [A21, A23]. Gjatë Turit të Universitetit [turi], Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pati mundësinë të evidentonte infrastrukturën e mirë të laboratorëve dhe pajisjeve [A79], pavarësisht përditësimit të vazhdueshëm të kapacitetit dhe pajisjeve laboratorike, për mundësimin e mësimdhënies praktike dhe metodologjisë së mësimdhënies [A23]. Stafi akademik i përditëson materialet e mësimdhënies në mënyrë periodike [A87] dhe mban shënime të veprimtarisë mësimore në regjistër, që shërben si dokumenti zyrtar për përcaktimin e frekuentimit të lëndës nga studentët, rezultateve dhe orëve efikase mësimore [B46]. Materialet e mësimdhënies i janë vënë në dispozicion studentëve në formën e teksteve shkollore akademike, leksioneve të shumëfishuara, manualeve, dokumenteve në formë elektronike, punimeve të mëparshme, mediave të komunikimit dhe programeve të IT-së [A23, 79, 87, 107-111; B33, 46].
- 4.2 Rregullat e provimeve, pasi miratohen, iu vihen në dispozicion studentëve, si dhe afishohen në këndet e informimit në mjediset e fakultetit në periudha të caktuara të vitit akademik [A23, <http://www.unkorce.edu.al/sq/rregullore-e-studimeve>]. Rezultatet e vlerësimeve bëhen me dije në mënyrë të tillë që të respektohen parimet e fshehtësisë dhe pritshmërive [<https://www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al/Home.do>]. Studentët mund të marrin informacion rreth mënyrës së vlerësimit të kursit, datave të provimeve dhe diplomimit në bazën e të dhënave EDDE3 dhe në seksionin e "Shërbimit Online" të faqes së internetit. Studentët kanë të drejtë të kontaktojnë me pedagogun për çfarëdolloj sqarimi në lidhje me performancën e provimit dhe notën [A41, 43]. Universiteti i pajis studentët që i kanë përmbushur detyrimet e programit me diplomën zyrtare [A23], që është miratuar nga universiteti. Diploma jepet së bashku me suplementin e diplomës, që përmban të gjithë informacionin e nevojshëm rreth programit të studimit që kanë ndjekur [B42, 43, 44, 45].
- 4.3 Programet e studimit i nënshtrohen procedurave të vlerësimit të vazhdueshëm të cilësisë, që përfshijnë Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë [A34]. Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NjSBC) analizojnë shqyrtimet e kurrikulës dhe përmirësimin e ambienteve në lidhje me cilësinë e programeve të studimit si për shembull: të përdorimit të laboratorëve, përditësimit të dokumenteve, mjeteve të IT-së, raportit të ngarkesës, metodave të mësimdhënies dhe mjeteve të vlerësimit [A39]. Të gjitha gjetjet pasqyrohen në Raportin e Vetëvlerësimit të Fakultetit [A50]. Performanca e stafit akademik matet përmes pyetësorëve të studentëve dhe informacionit që ofrojnë personalisht për performancën vjetore akademike dhe kërkimore [A92]. Ky vlerësim performance kryhet nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.
- 4.4 Universiteti i kushton vëmendje të veçantë rritjes së cilësisë së mësimdhënies [A21]. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përfshihet në mënyrë të drejtpërdrejtë në matjen e treguesve të performancës së programit të studimit, si dhe ka autonomi dhe akses operacional në të dhënat e universitetit [A34, 39]. Rritja e cilësisë është

pjesë e një procesi të vazhdueshëm. I gjithë stafi akademik i nënshtrohet procesit të vlerësimit, që kryhet çdo vit [A92]. Kjo gjë përshkruhet edhe në Manualin e Sigurimit të Cilësisë së Universitetit dhe detajohet në kalendarin e planit të veprimit [A39, 40]. Për të rritur cilësinë, departamentet organizojnë seanca të hapura mësimdhënieje për shkëmbimin e përvojës ndërmjet anëtarëve të personelit, si dhe vlerësojnë mësimdhënien e asistentëve të rinj, gjë që konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si **praktikë e mirë** [A88, 89].

- 4.5 Universiteti ofron tre programe studimi: Bachelor, Master dhe Doktoraturë [A47]. Pavarësisht faktit se ofron vetëm një program doktorature, baza e kërkimit shkencor është e mirë [M6]. Universiteti ndahet në 14 departamente, që nxisin, koordinojnë dhe organizojnë veprimtaritë kërkimore dhe të mësimdhënies [A47]. Niveli i kualifikimit është i mirë, pasi 50 për qind e stafit akademik mbajnë tituj dhe grada akademike [A59, 60]. Departamentet janë njësi bazë e mësimdhënies dhe kërkimit, të cilat organizojnë rregullisht mbledhje për të marrë vendime rreth çështjeve të rëndësishme lidhur me organizimin e veprimtarive kërkimore, botuese dhe promovuese [A76]. Në mbështetje të dokumenteve të ofruara nga institucioni, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm vlerëson se stafi akademik po punon drejt rritjes së veprimtarive kërkimore, gjë që bazohet kryesisht te kualifikimet dhe botimet e tyre [A60; B21; M6], por mbledhjet me personelin, kanë treguar se mund të ketë mungesë të fondeve të mbledhura përmes projekteve dhe veprimtarive të tjera që mbështesin kërkimin [M6; Anketimi i Profesorëve].
- 4.6 Universitetit nxit zhvillimin dhe kërkimin shkencor brenda institucionit [M2; M3; M6]. Nga buxheti vjetor “Kërkimi Themelor dhe Ekselencia” caktohen fonde për kërkimin, të cilat diskutohen në Rektorat dhe miratohen nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit. Buxheti detajohet deri në shkallë departamenti [A50]. Universiteti ka qenë dhe vazhdon të jetë pjesë e shumë projekteve ndërkombëtare, gjë që mbështet kryerjen e kërkimeve [A81, 96]. Bashkëpunimi dhe rrjetet e krijuara përmes këtyre partneriteteve e kanë përmirësuar më tej ndërveprimin dhe komunikimin shkencor ndërmjet kërkuesve [C11, 12]. Universiteti ka njësinë e Ekonomisë Eksperimentale Didaktike, që mbështet kërkimin në Fakultetin e Bujqësisë [A45]. Në ambientet e universitetit ndodhet edhe një qendër eksperimentale që mbështet stafin akademik dhe studentët e po të njëjtit fakultet, në kryerjen e kërkimit shkencor apo të zbatuar. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë gjë si karakteristikë **të praktikës së mirë**, që lehtëson zhvillimin e mëtejshëm të kërkimit shkencor në bujqësi.
- 4.7 Universiteti është angazhuar në ndërkombëtarizim përmes mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, dhe ka lidhur marrëveshje me shumë partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë, gjë që konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si karakteristikë e **praktikës së mirë** [C2; M4; M6]. Gjatë viteve të fundit, numri i projekteve ndërkombëtare është rritur përmes botimeve dhe simpoziumeve ndërkombëtare, një sërë marrëveshjesh, ku stafi akademik dhe studentët kanë qenë pjesë e përvojës ndërkombëtare të mësimdhënies, dhe punësimit të personelit që janë diplomuar jashtë vendit. Universiteti ka lidhur marrëveshje me partnerët dhe është pjesë e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare [A81]. Gjatë viteve të fundit, ai ka filluar të rrisë mobilitetin e personelit dhe të studentëve në kuadrin e programit Erasmus + [C2]. Gjatë mbledhjeve, studentët dhe personeli treguan përvojën e tyre ndërkombëtare [M4; M6]. Megjithatë shumica dërrmuese e personelit nuk kanë punuar jashtë vendit në pesë vitet e fundit, universiteti po ndërmerr hapa për trajtimin e kësaj çështjeje, duke u angazhuar në ndërkombëtarizim. Rezultatet e Anketimit të Stafit Akademik tregojnë se, gjatë pesë viteve të fundit, 91.95 për qind

e personelit nuk ka punuar në asnjë nga institucionet e arsimit të lartë jashtë vendit. **[Anketimi i Profesorëve]**.

- 4.8 Fushat e prioritetit të kërkimit shkencor janë përcaktuar në Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit **[A25]**. Gjithashtu, universiteti ka organizuar disa aktivitete shkencore, në përputhje me fushat e kërkimit **[A32; A122]**. Megjithatë, priorizimi dhe koordinimi i fushave të kërkimit brenda departamenteve midis stafit akademik dhe studentëve, konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si **dobësi** dhe grupi i **rekomandon** universitetit përgatitjen dhe zbatimin e një strategjie për të mbështetur zhvillimin sistematik të fushave të kërkimit, si prioritet në Planin e tij Strategjik të Zhvillimit. Departamentet kanë ekspertë kërkimi në çdo fushë kërkimi dhe një njohuri e tillë duhet të merret parasysh gjatë marrjes së vendimeve në shkallë strategjike në universitet. Rezultatet e Anketimit të Stafit Akademik tregojnë se, gjatë tre viteve të fundit, 79.87 për qind e stafit akademik nuk ka marrë asnjë fond për kërkimin shkencor nga institucioni **[A66;M6]**, gjë që tregon se mendimet e departamenteve me ato të drejtuesve të universitetit ndryshojnë. Siç përmendet edhe më sipër, priorizimi i fushave të kërkimit nga departamentet do të ndihmonte në koordinimin më të mirë të fondeve.
- 4.9 Procesi institucional i priorizimit të fushave të kërkimit kryhet nga Këshilli Shkencor dhe Bordi Botues, si dhe nga Zëvendës Rektori, që është përgjegjës për kërkimin shkencor **[A32]**, në përputhje me Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit **[A32; A33;A34]**. Gjatë mbledhjes me Grupin e Vlerësimit të Jashtëm, stafi akademik shprehu shqetësimin se kërkimi i tyre shkencor kufizohet për shkak të fondeve **[M6; A61]**.
- 4.10 Universiteti ndjek një politikë të favorshme për mobilitetin e stafit akademik, që ndërmarrin kërkime shkencore **[A26]**. Një gjë e tillë arrihet kryesisht përmes projekteve dhe partneriteteve **[M6; M7]**. Një tjetër hap që universiteti po ndërmerr për përmirësimin e kërkimit shkencor është ndërkombëtarizimi i studimeve **[M6;C11;C12]**. Kërkimi kryhet më tepër në shkallë individuale, se sa në mënyrë strategjike. Gjithashtu, siç u diskutua edhe më sipër, stafi akademik është i shqetësuar lidhur me nivelin e burimeve financiare për kërkimin **[M6;C11;C12]**.
- 4.11 Universiteti organizon një Konferencë ndërkombëtare vjetore, që synon promovimin e të gjithë kërkimeve shkencore të stafit akademik, studentëve dhe kërkuesve të ftuar **[A32, 122]**. Botimet dhe veprimtaritë e tjera shkencore në formën e punimeve në kuadrin e konferencës, dhe botimi i Buletinit Shkencor apo numrat e tij të veçantë, përbëjnë një mënyrë tejet të dobishme për rritjen e ndikimit të kërkuesve të universitetit. Gjithashtu, universiteti boton monografi, tezat e doktoratave apo libra të tjerë për stafin e tij akademik **[A76,80]**.
- 4.12 Universiteti ka ngritur një njësi që vlerëson ecurinë e rezultateve të kërkimit shkencor, që njihet si Këshilli Shkencor dhe Botues **[A32]**, i drejtuar nga Rektori dhe i përbërë prej akademikëve që mbajnë tituj shkencor, qofshin personel i universitetit apo të ftuar **[M6]**. Politikat institucionale të mbrojtjes së të drejtës intelektuale parashtrihen në Rregulloren e Këshillit Shkencor dhe Bordit Botues, si dhe në Rregulloren e Etikës **[A36]**, ku përcaktohen jo vetëm rastet e plagjiaturës, por edhe përgjegjësitë shkencore dhe individuale që kanë kërkuesit në lidhje me cilësinë e punimeve akademike. Promovimi i rezultateve të kërkimit shkencor bëhet përmes Gazetës së Universitetit, numrat specifike të së cilës shtypen dhe i dërgohen autorëve **[http://www.unkorce.edu.al/sites/default/files/buletini_2016.pdf]**. Nismat individuale të kërkuesve të rinj lidhur me kërkimin **[C11;C12]** nxiten dhe mbështeten përmes mbështetjes financiare ose botimit të kërkimit të tyre falas **[C11, 12; aM6]**.

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Për të përmirësuar cilësinë e mësimdhënies, departamentet organizojnë seanca të hapura mësimdhënieje për shkëmbimin e përvojës së mësimdhënies midis anëtarëve të personelit, si dhe për vlerësimin e procesit të mësimdhënies së asistent pedagogëve (pika 4.4; **Kapitulli I Standardi II.4**)
- Universiteti ka njësinë e Ekonomisë Eksperimentale Didaktike, që mbështet kërkimin në Fakultetin e Bujqësisë (pika 4.6; **Kapitulli II Standardi I.6**)
- Universiteti është i përkushtuar ndaj ndërkombëtarizimit përmes mobilitetit të stafit akademik dhe studentëve, si dhe ka lidhur shumë marrëveshje me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë (pika 4.7; **Kapitulli II Standardi I.3**)

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm identifikoi dobësinë e mëposhtme:

- Prioritizimi dhe koordinimi fushave të kërkimit brenda departamentit midis stafit akademik dhe studentëve (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4, Kapitulli II Standardi I.6**).

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm dha rekomandimet e mëposhtme:

- Universiteti duhet të përgatisë dhe zbatojë një strategji për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të fushave të kërkimit, të identifikuara si prioritete në Planin e tij Strategjik të Zhvillimit (pika 4.8; **Kapitulli II Standardi I.4, Kapitulli II Standardi I.6**).

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk bëri asnjë pohim.

Gjykimi

Standardet për Mësimdhënien, Mësimnxënien, Vlerësimin dhe Kërkimin janë përmbushur kryesisht.

Fusha e Vlerësimit 5: Studentët dhe Mbështetja e tyre

5.1 Procedura e pranimit është në përputhje me kërkesat e ligjit shqiptar për arsimin e lartë. Politikat për pranimin e studentëve në programet e studimit përfshihen në Planin Strategjik të Zhvillimit [A23, 26]. Përgjegjësitë për pranimin dhe regjistrimin e studentëve ndahen midis Sektorit të Studimeve dhe Qendrës së Karrierës së Studentëve [A21]. Departamentet koordinojnë fushatat promovuese me studentët e ardhshëm [A126,127]. Çdo vit, përfaqësuesit e universiteteve vizitojnë shkollat e mesme, ndërsa kandidatët e mundshëm vizitojnë ditët e hapura të organizuara nga universiteti. [M6] Manualët për studentët, broshurat dhe fletëpalosjet [A127], që ofrojnë informacion për programet e studimit, botohen dhe vihen në dispozicion përgjatë vitit, kryesisht në fillim dhe gjatë fushatave promovuese. Çdo vit akademik, universiteti organizon mbledhje informuese me studentët e vitit të parë, si dhe përgatit dhe shpërndan informacionet e nevojshme [A126, 127]. Universiteti ka afërsisht 4,750 studentë në të gjitha programet që ofron, dhe raporti i personelit me studentët është 1 me 27 [A3,77], por për programet e studimit që mbështeten në përdorimin e laboratorëve, raporti ulet në shkallën 1 me 15 [A77].

5.2 Komunikimi me studentët është shumë i mirë dhe efikas, dhe zakonisht kryhet përmes kontaktit fizik, emailit ose platformave virtuale, që iu vihen në dispozicion studentëve [A7 fq.59; M4]. Informimi dhe komunikimi mbështeten kryesisht nga Sektori i Informacionit, Teknologjisë dhe Komunikimit, ndërsa faqja e internetit përditësohet vazhdimisht, duke ofruar të gjithë informacionin e nevojshëm për rregulloret, regjistrimin, kurrikulën, provimet dhe notat e studentëve. [A23]. Universiteti komunikon me stazhierët përmes intranetit, faqes së internetit dhe emailit. Universiteti ka zbatuar një program digjitalizimi përmes sistemit ESSE3 [www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al/Home.do], një platforme virtuale për studentët që i ndihmon në procesin e komunikimit. Krahas këtyre, informacioni i ofruar përmes leksioneve dhe aksesit në nota, konsiderohet nga Grupi i Vlerësimit të Jashtëm si **praktikë e mirë**. Çdo student dhe anëtar i personelit ka një adresë personale emaili, që i vjen në ndihmë për procesin e komunikimit [M4; M6]. I gjithë informacioni për studentët, nga fillimi e deri në fund të studimeve të tyre, hidhet dhe ruhet në sekretari, duke përfshirë notat, adresën e vendbanimit, adresën e emailit dhe numrat e telefonave të studentëve. [A34, 44 www.unkorce.esse3.u-gov.rash.al].

5.3 Informimi dhe orientimi i studentëve është një proces i vazhdueshëm përgjatë të gjithë viteve të studimit [A21]. I gjithë informacioni hidhet në faqen e internetit ose në intranet [http://www.unkorce.edu.al]. Qendra e Karrierës luan rol të rëndësishëm në orientimin dhe mentorimin e studentëve [A124;A126;A127]. Studentëve u ofrohen shërbime ndihme, këshillimi dhe orientimi gjatë dhe pas studimeve të tyre [A44]. Studentët mendojnë se sistemi i mentorimit në universitet funksionon mirë [M4]. Ata marrin të gjithë ndihmën që u nevojitet gjatë studimeve, dhe mund të kontaktojnë me profesorët gjatë orarit zyrtar, leksioneve dhe seminareve [M4;M6]. Gjithashtu, në fund të studimeve, ata mund të zgjedhin edhe një mbikëqyrës për tezën e tyre. Gjatë studimeve, studentëve iu ofrohet mundësia për mobilitet brenda projekteve ndërkombëtare të Erasmus + [C2].

5.4 Universiteti ofron politika mbështetëse për studentët me aftësi të kufizuara ose të kategorive të veçanta [RVV fq.60]. Vetëm Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane ofron ashensor për të mundësuar aksesin në auditorët e katit të dytë, ndërsa të tjerat ofrojnë rampa [Turi i ambienteve]. Në të gjitha programet e studimit, ka një kuotë të caktuar për kandidatët nga grupet sociale në nevojë [M2; M4; A21]. Zakonisht, këta studentë përjashtohen nga pagesa e tarifës së shkollimit për një vit [M2;M4]. Nga rezultatet e anketimit të studentëve, 45% e tyre shprehen se mungon infrastruktura (rampat, ashensorët) për studentët me aftësi të kufizuara [A21; A23]. Megjithatë, institucioni është i vetëdijshëm për këtë situatë, dhe po punon për ta përmirësuar.

5.5 Universiteti ka katër biblioteka për studentët dhe personelin [turi]. Çdo fakultet i

universitetit ka bibliotekën e tij, të cilat ofrojnë literaturë të të gjitha llojeve si libra, buletine, enciklopedi, harta muri, gazeta, albume, si dhe mbështetje gjuhësore dhe terminologjike. Nëpër biblioteka gjenden 11,890 tituj gjithsej dhe 37,402 kopje në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, kryesisht në anglisht dhe frëngjisht **[Turi i Kampusit]**. Aty gjenden edhe libra të botuar në shqip nga stafi akademik i universitetit **[A78]**. Të gjithë këta libra janë edhe pjesë e bibliotekave të universitetit. Megjithatë, digjitalizimi i burimeve nuk ka arritur shkallën e duhur të zhvillimit **[turi]**. Gjatë mbledhjeve me stafin akademik dhe personelin mbështetës, u evidentua se është ndërmarrë tashmë një projekt, që do të ndihmojë digjitalizimin e bibliotekës së universitetit dhe krijimin e bibliotekës online **[M4; M5; M6]**, dhe Grupi i Vlerësimit të Brendshëm **pohon** ecurinë e shënuar në këtë projekt.

5.6 Shërbimet e tutorimit dhe këshillimit për studentët përshkruhen në Rregulloren e Studimeve **[A28]**. Krahas procesit formal të tutorimit, komunikimi ditor ndërmjet pedagogëve dhe studentëve ofron më tepër mundësi për mbështetjen dhe lehtësimin e ecurisë së studentëve të ciklit të parë dhe të dytë **[A23]**. Studentëve në vitin e tretë të ciklit të parë iu ofrohet mentorim i veçantë për t'i mbështetur gjatë përzgjedhjes dhe përgatitjes së tezës, dhe për t'i këshilluar rreth mundësive të ardhshme për punësim **[M4; M6]**. Qendra e Karrierës ofron një sërë shërbimesh dhe mbështetje për studentët që vazhdojnë aktualisht studimet **[A124]**. Një tjetër veprim i rëndësishëm që ndërmerr universiteti për të mbështetur dhe ndihmuar studentët e tij është përgatitja e listave të notave të studentëve në gjuhën angleze në rast transferimi studimesh. Lista e notave është një dokument zyrtar që ndiqet nga përshkrimi i modulit, dhe nënshkruhet e vuloset nga Dekani dhe Rektori **[M4]**. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm e identifikoi këtë gjë si karakteristikë të **praktikës së mirë**.

5.7 Studentët kanë të drejtën e përfaqësimit në shkallë institucionale të universitetit **[A7 fq.61]**. Ata kanë të drejtë të votojnë për Rektorin dhe Dekanin e Fakultetit, si dhe për përfaqësuesit e Senatit të universitetit **[A21, 46]**. Gjithashtu, ata kanë përfaqësuesit e tyre në Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe njësitë e fakultetit. Studentët kanë si formë organizimi Këshillin e Studentëve, që është një organizatë e pavarur brenda universitetit dhe ndihmon në promovimin dhe mbështetjen e interesave të studentëve **[A42, A91]**. Krahas kësaj, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohon ofrimin e kartës së studentit, që do t'i ndihmojë studentët të kenë akses falas, apo t'i u ofrohen shërbime falas ose me pagesë të reduktuar. Karta është prodhuar, por nuk është venë ende plotësisht në funksion **[<http://www.unkorce.edu.al/sq/keshilli-studentor>]**.

5.8 Universiteti ndjek një politikë mbështetëse të përshtatshme dhe të efektshme për të siguruar pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari kulturore dhe sportive **[A129]**. Këta të fundit organizojnë panairë dhe shesin produkte, për të mbledhur fonde për bamirësi **[A129]**. Universiteti mbulon kostot financiare dhe ofron mjete transporti për udhëtimet në terren të parashikuara në programet e studimit të historisë, gjeografisë, turizmit, gjuhësisë dhe bujqësisë. Gjithashtu, studentët organizojnë veprimtari të ndryshme sportive **[A83]**. Ceremonia e diplomimit është një tjetër veprimtari që organizohet nga universiteti **[A7 fq.62; M4]**.

5.9 Universiteti është tejet i orientuar drejt punësimit të ardhshëm të studentëve të tij **[A25]**, ku Qendra e Karrierës luan një rol shumë të rëndësishëm **[M5]**. Gjatë mbledhjeve, punëdhënësit u shprehën se pjesa më e madhe e punonjësve vinin nga universiteti, kryesisht në sistemin bankar, që konstatoi se 95 për qind e personelit ishin të diplomuarit e universitetit **[M4; M5]**. Universiteti ka një bazë të dhënash për të gjithë studentët e punësuar përgjatë viteve **[M2]**. Për të ndihmuar në punësimin e studentëve në të ardhmen, universiteti ka lidhur disa marrëveshje me institucionet publike dhe private dhe me disa kompani **[A99-A106]**. Këto kompani i ofrojnë studentëve stazhe dhe shërbejnë si punëdhënës të mundshëm. Universiteti merr pjesë si partner me të drejta të plota në Panairin vjetor të Punës, të organizuar nga Bashkia e Korçës, që është edhe një nga partnerët e tij më të ngushtë **[A106]**.

Gjetje

Praktikat e mira

Grupi i vlerësimit të jashtëm identifikoi karakteristikat e mëposhtme të praktikës së mirë:

- Programi i digjitalizimit të universitetit, sistemi ESSE3 (pika 5.2; **Kapitulli I Standardi III.2**)
- Përgatitja e listës së notave për studentët në rast transferimi studimesh jashtë vendit (pika 5.6; **Kapitulli I Standardi III.3**).

Dobësitë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk identifikoi asnjë dobësi.

Rekomandime

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm nuk dha asnjë rekomandim.

Pohimi i veprimeve të ndërmarra

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pohoi veprimet e ndërmarra si më poshtë:

- Universiteti ka ndërmarrë tashmë një projekt që do të ndihmojë në digjitalizimin e bibliotekës së universitetit dhe krijimin e bibliotekës online (pika 5.5; **Kapitulli I Standardi III.5**)
- Universiteti ka prodhuar kartën e studentit, që do t'i ndihmojë studentët të kenë akses falas, apo t'iu ofrohen shërbime falas ose me pagesë të reduktuar (pika 5.7; **Kapitulli I Standardi III.5**).

Gjykimi

Standardet për Studentët dhe Mbështetjen e Tyre janë përmbushur plotësisht.